

VENDIM
Nr. 92, datë 20.4.2018

**MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE TË
FURNIZUAR NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT, PËR MUAJIN PRILL 2018**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 84, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017; të nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.4.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve, mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin prill 2018,

konstatoi se:

- OSHEE sh.a., me shkresën nr. 6158 prot., datë 5.4.2018 (protokolluar në ERE me nr. 72/3, datë 10.4.2018), dërgoi në ERE aplikimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin prill 2018.

- Të dhënat e paraqitura nga OSHEE sh.a. në këtë aplikim u krahasuan me raportimet e OSHEE sh.a. mbi blerjen e energjisë në treg të parregulluar për muajin prill 2018, të dërguar në ERE paraprakisht këtij aplikimi.

- Çmimi maksimal i blerjes së energjisë në treg, të parregulluar për muajin prill 2018, rezulton 31.79 euro/mwh.

- OSHEE sh.a., me gjithë komunikimet e vazhdueshme të zhvilluara në kuadër të procesit të nisur mbi miratimin e çmimit të shitjes për klientët e FMF-së, për periudhën janar–mars 2018, nuk ka mundur të paraqesë informacion mbi koston e disbalancave për njësi të energjisë së furnizuar në rolin e furnizuesit të mundësisë së fundit edhe për muajin prill 2018.

- Mbas analizimit të informacionit të dërguar nga OSHEE sh.a., mbi këtë aplikim dhe informacioneve periodike të shoqërisë, çmimi i furnizimit me energji elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit rezulton 6.85 lek/kwh për muajin prill 2018.

- Përcaktimi i çmimit më të ulët se 9.5 lekë/kwh për klientët e FMF-së nuk jep sinjale nxitëse për daljen e tyre në treg të parregulluar.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë çmimin e shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga furnizuesi i mundësisë së fundit prej 9.5 lekë/kwh, për muajin prill 2018.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë të interesuarit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti